



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
BASHKIA KURBIN
KRYETARI

Nr. _____ prot.
____.____.2020

Laç, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 30.03.2020.

Për: Operatorin ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, **Adresa:** Tiranë, Vore, Autostrada Tiranë - Durres, Km. 10, Rruga dytesore Vore – Albania.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim” Mallra (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-51033-02-19-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente për Aparatin, Çerdhen, Pallatin e Kulturës dhe Arsimin, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit (nqs ka lote i ndare sipas loteve) : **2,581,833** (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë.

Data e zhvillimit të tenderit: 03/03/2020

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës me përfundim në 31/12/2020.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** doferata ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “DIMEX” SHPK, me numër NIPTI J618055190.
Vlera e ofertuar: **1,351,000** (një milion e treqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë **pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, me numër NIPTI K91624505A.
Vlera e ofertuar: **1,595,300** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë **pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik “LEON GROUP” SHPK, me numër NIPTI L51313013I.
Vlera e ofertuar: **1,876,958.33** (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e

nëntëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë **pa TVSH**.

4. Operatori ekonomik **“ATLANTIK 3” SHPK**, me numër NIPTI **K22218003V**.
Vlera e ofertuar: **2,250,000** (dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **“MURATI D” SHPK**, me numër NIPTI **K42003004T**.
Vlera e ofertuar: **2,329,700** (dy milion treqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind) lekë **pa TVSH**.
6. Operatori ekonomik **“PASTRIME SILVIO” SHPK**, me numër NIPTI **K91413010N**.
Vlera e ofertuar: **2,529,800** (dy milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind) lekë **pa TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“DIMEX” SHPK**, me numër NIPTI **J61805519O**.
2. Operatori ekonomik **“EURO MEGA 2010” SHPK**, me numër NIPTI **K91624505A**.
3. Operatori ekonomik **“LEON GROUP” SHPK**, me numër NIPTI **L51313013I**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “DIMEX” SHPK:

Në mbështetje të nenit 53, pika 3 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, nenit 53, pika 5, shkronja “a” të këtij ligji ku parashikohet se: **“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar”**, si dhe të nenit 66, pika 3, Kreu VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar, ku parashikohet se: **Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

Argumentimi juaj i datës 12.03.2020 si rezultat i ofertës anomalisht të ulët, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente për Aparatin, Çerdhen, Pallatin e Kulturës dhe Arsimin, Bashkia Kurbin” nuk është bindes dhe jo i rregullt në të gjitha elementet e saj, prandaj bazuar në nenin 56, pika 2 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, ofetra juaj refuzohet për sa më poshtë vijon:

- Analizat e çmimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, nuk janë paraqitur sipas standarteve në fuqi në lidhje me elementet përbërës të një analize çmimi, konkretisht për të gjitha analizat e paraqitura nga ana juaj për detergjentet, mungonë referenca ligjore/teknike.
- Në elementin lëndë e parë, e analizave mungon origjina e lëndëve të para dhe referenca teknike.

- Fuqia punëtore nuk është cilësuar në mënyrën e njohur në orë pune, çmimi për orë pune, për rezultat edhe vleften në lekë. Gjithashtu nuk janë detajur sigurimet shoqërore dhe shendetsore.
- Elementi i analizës makineri për prodhimin e detergjenteve nuk është cilësuar në llojin e makinerisë, orë pune makinerie dhe cmimin për orë pune, për rezultat edhe vleften në lekë.
- Elementi transport materiale nuk është cilësuar nëse ka.
- Për ambalazhimin nuk ka një referencë sipas standartit në fuqi.
- Referuar argumentimit tuaj që keni bërë për detergjentet, konstatohet se për të njëjtin element përbërës të detergjentit si (ujë dhe sodë kaustike) rezultojnë cmime të ndryshme.
- Gjithashtu për artikujt materiale pastrimi ju keni paraqitur në argumentimin tuaj si provë fatura të vitit 2018, të cilat për ne nuk janë bindëse, pasi cmimet e tregur ndryshojnë nga viti në vit.

2. Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK:

Në mbështetje të nenit 53, pika 3 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, _nenit 53, pika 5, shkronja “a” të këtij ligji ku parashikohet se: **“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar”**, si dhe të nenit 66, pika 3, Kreu VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar, ku parashikohet se: **Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik “Euro Mega 2010” Shpk, rezultoi nga KVO ofertë anomalisht e ulët dhe ndodhur në këto kushte me date 06.03.2020 KVO, në mbështetje të nenit 56 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar , të nenit 66, pika 5, Kreu VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, vendosi t’i kërkoj operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” Shpk, që të paraqes **me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime** duke argumentuar origjinalitetin e mallrave dhe dokumentuar me prova shkresore sqarimet, për të gjitha çmimet e zërave (mallrave) që keni paraqitur në këtë procedurë prokurimi.
Duke qene se operatori ekonomik nuk solli shpjegime për ofertë anomalisht të ulët brenda afteve ligjore (brenda 3 ditëve pune), KVO vendosi ta refuzojë ofertën e operatorit ekonomik duke e skualifikuar.

3. Operatori ekonomik “LEON GROUP” SHPK:

Në mbështetje të nenit 53, pika 3 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe**

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, nenit 53, pika 5, shkronja “a” të këtij ligji ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar”, si dhe të nenit 66, pika 3, Kreu VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar, ku parashikohet se: Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimit elektronik K.V.O konstatohet se operatori ekonomik “Leon Group” Shpk, nuk ka paraqitur: 1. Autorizim Prodhuesi, kriteri i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.5 në DST. 2. OE nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjet transporti sipas pikës 2.3.5 që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST. Sqarohet se OE për mjetin me targë AA572HD ka paraqitur kontratë qeraje, police sigurimi dhe leje qarkullimi dhe nuk ka paraqitur Çertifikatën e pronësisë së mjetit, Kontrollin teknik (SGS) dhe taksat.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Operatorin ekonomik “**ATLANTIK 3**” SHPK, Adresa: Tiranë, Vore, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 10, Rruga dytesore Vore – Albania, me përfaqësues ligjor **Zj. Shpresa Hoxha**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **2,250,000** (dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, Lagjia Nr.3 Laç, Tel/Fax 0035553222270, Cel: 0682205942, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **2,329,700** (dy milion treqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **19.03.2020**.

Ankesa: ka ose jo

Nuk ka patur

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Majlinda CARA